

€549

per person

STRASBOURG - COLMAR | Tren Panoramike në Alpe - ST. MORITZ - ZYRIH - LUCERNE LIQENI KOMO- MILANO Nisje: • 4 Dhjetor • 24 Dhjetor

DESTINACIONI

Strasbourg - Colmar -
Zyrih - St. Moritz -
Basel - Alpet
Zviceriane - Alpet
Italiane - liqeni Komo -
Milano

PERIUDHA

Festat e Dhjetorit '2026

KOHËZGJATJA

4 Ditë

TRANSPORTI

Me Avion

**FESTAT E DHJETORIT 2026****Nisje 4 Dhjetor - Kthim 7 Djeto**

- 4 Ditë / 3 Netë
 - Çmimi: **549€**
 -  Nisja: 05:50 (Tiranë) → 08:10 (Mulhouse)
 -  Kthimi: 21:45 (Milano) → 23:40 (Tiranë)
-

 KRISHTLINDJE 2026**Nisje 24 Dhjetor - Kthim 27 Djeto**

- 4 Ditë / 3 Netë
- Çmimi: **639€**
-  Nisja: 05:50 (Tiranë) → 08:10 (Mulhouse)
-  Kthimi: 21:45 (Milano) → 23:40 (Tiranë)

1

DITE

COLMAR - STRASBOURG

Takimi në aeroportin e Tiranës me shoqëruesin 2 orë përpara fluturimit.

Fluturimi direkt Tiranë – Mulhouse. (1 ore : 40 min)

Pas formaliteteve aeroportuale, nisja me autobus drejt **Colmar**, një nga qytetet më karakteristike të Alsace.

Vizitë në këmbë në qendrën historike të Colmar, ku do të shohim shtëpitë tradicionale shumëngjyrëshe, rrugicat mesjetare dhe zonën e famshme **La Petite Venise - Venecia e Vogël**.

Në këtë periudhë qyteti është i dekoruar për festat e fundvitit dhe zhvillohen **Tregjet e Krishtlindjeve të Colmar**.

Kohë për drekë dhe më pas nisja drejt **Strasbourg**.

Pas mbërritjes, vizitë e qytetit:

- Qendra historike **Grande Île**
- **Katedralja Notre-Dame de Strasbourg**
- Sheshi **Kléber**
- **Place Gutenberg**
- Lagjja karakteristike **Petite France**
- Kanalet dhe urat historike të qytetit
- Tregjet e Krishtlindjeve

Në mbrëmje akomodimi në hotel.

Fjetje në Strasbourg.

Mëngjesi në hotel.

Nisja drejt Zvicrës dhe qytetit të **Lucernës**, i pozicionuar në brigjet e Liqenit të Lucernës dhe i rrethuar nga Alpet Zvicerane.

Vizitë e qytetit:

- **Chapel Bridge - Kapellbrücke**

- Qendra historike

- **Lion Monument**

- Brigjet e Liqenit të Lucernës
- Sheshet dhe rrugicat karakteristike të qytetit

Kohë për drekë dhe shëtitje.

Pasdite nisja drejt **Zyrihut**.

Pas mbërritjes, vizitë panoramike dhe në këmbë:

- **Bahnhofstrasse**

- Qyteti i Vjetër - **Altstadt**

- **Grossmünster**

- **Fraumünster**

- Lumi Limmat
- Brigjet e Liqenit të Zürich
- Tregjet e Krishtlindjeve

Në mbrëmje akomodimi në hotel.

Fjetje në Zyrih.

Mëngjesi në hotel.

Nisja herët me autobus nga Zürich drejt **St. Moritz**, një prej destinacioneve alpine më të famshme të Zvicrës.

Udhëtimi kalon përmes peizazheve karakteristike zvicerane drejt kantonit Graubünden dhe Engadin.

Mbërritja në **St. Moritz** dhe kohë për një shëtitje të shkurtër në qendër dhe pranë liqenit.

13:55 - Nisja me tren nga St. Moritz

Fillon një nga pjesët më të bukura të udhëtimit: **udhëtimi panoramik me tren përmes Alpeve Zvicerane**, në itinerarin e famshëm të linjës së Berninës.

Gjatë udhëtimit do të shijojmë pamje spektakolare të:

- Alpeve Zvicerane
- Luginës Engadin
- Morteratsch
- Bernina Pass
- Lago Bianco
- Alp Grüm
- Luginës së Poschiavo
- Viadukteve dhe peizazheve alpine

Vazhdimi i udhëtimit drejt **Tirano**, në Itali.

Pas mbërritjes në Tirano, takimi me autobusin dhe nisja drejt **Liqenit Como**.

Mbërritja në mbrëmje dhe akomodimi në hotel.

Fjetje në zonën e Liqenit Como.

Mëngjesi në hotel dhe check-out.

Nisja për vizitën e **Como**, një prej qyteteve më elegante të Lombardisë, i vendosur në brigjet e liqenit me të njëjtin emër.

Gjatë vizitës do të shohim:

- Qendrën historike të Como
- **Duomo di Como**
- Piazza Cavour
- Shëtitoren buzë liqenit
- Portin dhe zonën historike

Pas vizitës, nisja drejt **Milanos**.

Mbërritja dhe fillimi i vizitës së kryeqytetit të Lombardisë:

- **Castello Sforzesco**
- Via Dante
- **Piazza del Duomo**
- **Duomo di Milano**
- **Galleria Vittorio Emanuele II**
- **Teatro alla Scala**
- Qendra historike e Milanos

Kohë për drekë, shopping dhe për të shijuar atmosferën e qytetit.

Në periudhën e fund-nëntorit/fillim-dhjetorit Milano është i dekoruar për sezonin festiv, duke e bërë vizitën edhe më tërheqëse.

Pas përfundimit të vizitave, nisja drejt Aeroportit të Milanos.

Kalimi i procedurave doganore dhe nisja për në Tiranë me fluturim direkt (1 ore : 20 min)

✓ PËRFSHIHET

- ✓ Udhëtimi vajtje-ardhje me avion Tiranë - Mulhouse dhe Milano - Tiranë Transfertat dhe Shëtitjet me autobus. Akomodimi në hotele 4 yje për 1 natë në Strasbourg, 1 natë në Zyrih dhe 1 natë në liqenin Komo Bileta trenit te kuq St. Moritz - Tirano Mëngjeset për të gjitha ditët e udhëtimit. Guida në gjuhën shqipe gjatë Turitejohet të merret me vete në avion vetëm një çantë me përmasa 40cm x 30cm x 20cm deri në 10 kg. (Kujdes - Mbi këto përmasa dhe Bagazh për checkin ka shpenzime ekstra).

× NUK PËRFSHIHET

- × Drekat dhe Darkat gjatë udhëtimit Biletat e hyrjes në Muze dhe Monumente Turistike Taksat e qyteteve 12€ në total për 3 netët e cila paguhet ne zyrë bashkë me pagesën e turit.

VENDTAKIMI I NISJES

- Nga aeroporti Nënë Tereza, ku duhet të paraqiteni minimumi 2 orë përpara

POLITIKAT E ÇMIMIT PËR FËMIJËT

- Fëmijët në moshën 2 - 11.99 vjeç përfitojnë 40€ zbritje nga cmimi i paketës

Shenim: Kjo politike hyn në fuqi vetëm nëse fëmijët akomodohen në dhomë me 2 të rritur.

DOGANA

- 1) Pashaportë me vlefshmëri minimumi 3 muaj
- 2) Nuk duhet të keni kaluar në 6 muaj e fundit më shumë se 90 ditë qëndrimi në vendet e BE

INFORMACIONE

- Akomodimi në dhomë teke (single) është me ekstra pagesë në vlerën 30% mbi çmimin për person.
 - Nëse krevati nuk do të jetë dopio, atëherë do të jenë dy krevatë teke të bashkuar.
 - Nëse shtrati për personin e tretë/katërt nuk do të jetë standart, atëherë do të jetë sofa bed (shtrat i shtuar në dhomë).
 - Operatori Turistik nuk mban përgjegjësi për personat e kthyer nga policia për arsye të ndryshme sic janë mungesë dokumentacioni, ekspuls, skadenca e mjetit identifikues, etj.
 - Nëse nuk i keni mbushur 18 vjeç dhe udhëton pa praninë e njërit ose asnjërit prej prindërve, ju nevojitet prokurë e noterizuar në gjuhën angleze.
 - Ekziston mundësia që disa nga përmbajtjet e hotelit/udhëtimit të mos jenë aktualisht në funksion për shkak të rrethanave objektive, të cilat operatori nuk mund të ndikojë.
 - Çmimet dhe disponueshmëria e muzeumeve, ekskursioneve dhe cdo aktivitet tjetër lokal mund të ndryshojnë dhe janë përgjegjësi e vetë Operatorëve Lokale që mundësojnë këto shitje.
- Për cdo ndryshim në lidhje me këto aktivitete, klienti lajmërohet përpara kryerjes së shërbimit.

INFORMACIONE

DESTINACIONI	Strasbourg - Colmar - Zyrih - St. Moritz - Basel - Alpet Zviceriane - Alpet Italiane - liqeni Komo - Milano
TRANSPORTI	Me Avion
ÇMIMI	€549.00 / person
ZBRITJE FËMIJË	99% (€8.00)

